



Enheten för flerspråkighet, EFF

- Ka për qëllim aktivitetet komunale dhe të pavarura.
- Mësimdhënja e gjuhës amtare në shkollat fillore, të përshtatur dhe të mesme të përshtatur.
- Udhëzues studimi në gjuhën amtare.
- Mbështetje hyrëse në gjuhë amtare.
- Anket apo detyrë hartuese në gjuhën amtare.
- Provim në lënden e gjuhë amtare ose në kursin e gjuhës amtare.

Enheten för flerspråkighet

flersprakighet@ uppsala.se

018-727 20 26



Mësimi në gjuhën amtare



flersprakighet.uppsala.se



Kush mund të lexojë lënden në gjuhën amtare?

(Shenim nuk vlen per gjuhët e pakicave)

Një nxënës që ka njërin prind apo kujdestar me një gjuhë amtare të ndryshme nga suedishtja duhet ti afrohet gjuha amtare nëse:

1. Gjuha është gjuhë e përditëshme e komunikimit të nxënësit në shtëpi.

2. Nxënësi ka njohurit bazë të gjuhës.

Nxënësi duhet të flasë dhe të kuptojë gjuhën. Mësimi është në gjuhën amtare dhe ndjek planprogramin kombëtar

Gjuha e pakicave kombëtare

Suedia ka këto gjuhë të pakicave: Finlandisht, Meänkieli, Sami, Romanisht, dhe Jidish. Për t'ju lejuar të lexojnë një gjuhë të pakicës kombëtare duhet ti përkisni grupit të pakicës. Nxënësi nuk ka nevojë të flasë gjuhën në shtëpi ose të ketë njohuri bazë të gjuhës.

Janë dy planprograme dhe në aplikacion ju duhet të zgjidhni nëse nxënësi do të studijojë si folës i gjuhës amtare apo fillestar.

Njësia për shumë gjuhësi (EFF) kordinon mësimin e gjuhës amtare në Uppsala.

Njohuri Bazë

Njohuritë bazë janë të nevojshme për të gjitha gjuhët, përveç gjuhëve të pakicave. Mësuesja vlerëson njohuritë bazë të nxënësit në lidhje me fillimin mësimdhënjes. Vlerësohen si të kuptuarit e të dëgjuarit ashtu dhe aftësia gojore. Informacioni mbi njohuritë bazë mund të gjendet në faqen e internetit EFF

Si të aplikoni

Është prindi apo kujdestari i nxënësit ai që bënë aplikimin. Formularët janë të disponueshëm në shkollë dhe gjithashtu në faqen e internetit të EFF. Plotësoni formularin, firmosni dhe dorëzoheni në shkollën e nxënësit. Drejtori duhet të miratojë aplikacionin dhe më pas shkolla duhet ta dërgojë në EFF, më së voni 15 qershor për vitin e ardhshëm akademik. Aplikacioni që mbërrin më pas datës 15 qershor nuk mund të garantohet vendi.

Kështu do të organizohet mësimi

Në Uppsala, sker mësimi i gjuhës amtare zhvillohet jashtë kohës së garantuar të mësimin. Kështu, mësimet rezervohen jashtë orarit të mësimin, shpesh pas përfundimit të ditës së shkollës. Nxënësit e klasës F-5 kanë mësim në shkollën e tyre. Nxënësit e klasëve 6-9 mbledhen në grupe të përbashkëta në një shkollë të caktuar, pasdite vonë ose në mbrëmje. Nxënësi shkon vetë në shkollën e caktuar. Nëse nxënësi nuk ka një kartë autobusi, mësuesi i gjuhës amtare do të shpërndajë një biletë autobusi.

Më shumë informacion

Në faqen e internetit të EFF, do të gjeni më shumë informacion rreth mësimin të gjuhës amtare në Uppsala.

flersprakighet.uppsala.se

